




Republika e Kosovës
Republika Kosovo/Republic of Kosovo
Komuna Dragash/ Opština Dragaš/ Dragas Municipality



Kuvendi Komunal
01 Nr.060-01-16999/2
Dt.02.08.2018
Dragash

Në bazë të nenit 12, paragrafi 12.2 pika d) dhe nenit 14, paragrafi 1 të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" nr.28, qershor 2008), nenit 7, paragrafi 3 të Ligjit 04/L-144 për Dhënie në shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës Komunale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" nr.35/17 dhjetor 2012), nenit 5 të Rregullores QRK 23/2013, për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimit të pronës së paluajtshme të Komunës dhe nenit 32, paragrafi 32.2 i Statutit të Komunës së Dragashit 01 Nr.06-103/1 i dt. 11.09.2008, pas shqyrtimit të Propozimit të Kryetarit të Komunës, Kuvendi Komunal i Dragashit, në seancën e dt.02.08.2018, miraton këtë:

V E N D I M
PËR DHËNIEN PARAPRAKE NË SHFRYTËZIM AFATSHKURTËR TË PRONËS
NË PRONËSI KOMUNALE

- I. MIRATOHET** Propozimi i Kryetarit të Komunës së Dragashit për dhënie paraprake në shfrytëzim afatshkurtër, prej 5 viteve, të pronës dhe lokaleve në pronësi të Komunës që gjenden në parcelat kadastrale:
- 1.1.** Në pronësi të Komunës parcela kadastrale **P-70601014-00781-0, ZK Dragash** Lokali i ish-"Emin Durakut" (tani kafiteri). me sipërfaqe 60,98 m/2, dhe
- 1.2.** Në pronësi të Komunës parcela kadastrale **P- 70604014-00781-0 ZK Dragash** ish- "Pro-Credit Bank", me sipërfaqe (80,94 m/2 lokal dhe bodrum 27,84 m/2) apo gjithsejt 108,78 m/2.
- II.** Qëllimi i dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës të cekur në pikën **I** të këtij vendimi, është ruajtja dhe rritja e vlerës së pronës publike komunale, si dhe rritja e të hyrave vetanake.
- III.** Për shkak të natyrës së objekteve dhe banuesve, në këto lokale, nuk mund të vendoset skara.
- IV.** Procedura për dhënie e pronës së paluajtshme në pronësi të Komunës në shfrytëzim afatshkurtër realizohet përmes ankandit publi, që e zbaton Zyra e Prokurimit.

- V. Të drejtat dhe përgjegjësitë e Komunës me shfrytëzuesit e pronës Komunale do të rregullohen me kontratë të veçantë të nënshkruar nga Kryetari i Komunës.
- VI. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset, Komisioni vlerësues për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës, Kryetari i Komunës, organi kompetentë për pronë dhe organi kompetentë për regjistrimin e pronës së paluajtshme.
- VII. Vendimi hyn në fuqi 15 ditë nga regjistrimi në Protokolin e MAPL-së për vlerësim të ligjshmërisë dhe 7 pas publikimit në web-faqen e Komunës.

KRYESUESI I KUVENDIT



Betim Merdiu